



Datë: 27.03.2025
Numër Protokolli: 2275/2025

A.nr.224/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2127/2024, të datës 30.12.2024, të parashtruar nga ankuesi G.SH., kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues të Kosovës, në çështjen juridiko-administrative “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi, 1.1, nenin, 16 paragrafi, 3 dhe nenin, 18 paragrafi, 1 nën paragrafin, 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 27.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.224/2025 e datës 27.01.2025, e parashtruar nga ankuesi G.SH.
- II. Mbetët** në fuqi Lista e rezultateve përfundimtare me numër protokolli 536, e datës 31.12.2024, e publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, për pozitën *Udhëheqës i Pavijonit* në Burgun e Sigurisë së Lartë.

A r s y e t i m

Ankuesi G.SH. (*tutje referuar vetëm* Ankuesi), më datë 27.01.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 567/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së gradimit për pozitën e punës *Udhëheqës i Pavijonit* në Burgun e Sigurisë së Lartë, i shpallur sipas konkursit të brendshëm me numër protokolli 297 të datës 19.08.2024, nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm* Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 14.02.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova (*tutje referuar vetëm Kolegji i Këshillit*): Ankesën me numër protokolli 567/2025 të datës 27.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së; Konkursin e Brendshëm me numër protokolli 297 të datës 19.08.2024; Listën e rezultateve preliminare me numër protokolli 461 të datës 02.12.2024; Listën e rezultateve përfundimtare të intervistës me numër protokolli 525 të datës 24.12.2024; Listën e rezultateve përfundimtare me numër protokolli 536 të datës 31.12.2024; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën dhe Përgjigjën në ankesë të datës 14.02.2025; Kërkesën dhe aprovimin për procedurën e rekrutimit me numër protokolli 808 të datës 08.08.2024; Vendimin me numër protokolli 101 i datës 24.10.2024 për emërimin e komisionit vlerësues; Akt emërimet e anëtarëve të komisionit; Listën e aplikantëve me numër protokolli 444 të datës 14.11.2024; Kërkesën për punësim të ankuesit, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesën për punësim të kandidatit A.M, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Testet me shkrim të ankuesit dhe kandidatit A.M. A.S.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **sepse**: Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 19.08.2024 ka shpallur Konkursin e brendshëm me numër protokolli 297, për pozitën e punës *Udhëheqës i Pavijonit në Burgun e Sigurisë së Lartë*.

Tutje sipas shkresave të lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar katër (4) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili i është nënshtruar të gjitha procedurave të testit, gjegjësisht testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ku sipas Listës së Rezultateve Përfundimtare me numër protokolli 536 të datës 31.12.2024, të Kryesuesit të Komisionit, rrjedhë se ankuesi me gjithsejtë 66.62 pikë të arritura nga kjo procedurë e gradimit është renditur i dyti, pas kandidatit A.M i cili me gjithsejtë 91.5 pikë të arritura është shpallur kandidat fitues për pozitën *Udhëheqës i Pavijonit në Burgun e Sigurisë së Lartë*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultateve të lartë theksuara, thekson se dyshoj se Komisioni nuk e ka vlerësuar drejtë në fazën e testit me shkrim dhe kërkon që të hedhet poshtë si e pa bazuar rezultati i arritshmërisë së pikëve në test. Në kuptim të vendosjes lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me nëpunësit me status të veçantë, gjegjësisht nenit 6 paragrafit 1.1 dhe 2, ku përcaktohet: ***“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës;. 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkelleve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin.*”**

Andaj, duke u bazuar në atë se të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil me status të veçantë, Kolegji i Këshillit, ju referua Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, duke konstatuar kështu se konkursi i brendshëm për pozitën *Udhëheqës i Pavijonit* në Burgun e Sigurisë së Lartë, është hapur në pajtim me nenin 7 të këtij udhëzimi, ngazë në këtë rast kemi të bëjmë me avancimin në grada, ndërsa kriteret e përcaktuara për gradën *Udhëheqës* dhe Komisioni për procesin e gradimit janë në pajtim me nenin 10 dhe 11 të këtij udhëzimi.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit, i'u referua dispozitave të nenit 13 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, ku përcaktohet se: *2. Procedura e testimit mbahet sipas radhitjes vijuese: 2.1.testi me shkrim; 2.2.intervista me gojë.; dhe nenit 14, i cili përcakton se: 1.Testi me shkrim përpilohet në gjuhët zyrtare dhe përbëhet nga pesëdhjetë (50) pyetje. Secila përgjigje e saktë ka vlerën e dy (2) poenave. 2.Testi hartohet për të testuar njohuritë në fushën e legjislacionit penal, ekzekutimin e sanksioneve penale, Institucioneve Korrektuese dhe shkathtësitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimit. 3.Rezultati minimal i kërkuar për të kaluar me sukses testin është shtatëdhjetë (70) poena të testit..., si dhe nenit 15, ku përcaktohet se: Në intervistë kandidatëve do t'u parashtrihen pyetje të standardizuara duke përfshirë aftësitë komunikuese, të udhëheqjes, vendimmarrjes dhe njohuritë profesionale.;* dhe ndërlidhur me shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se testi me shkrim ka qenë i përpiluar me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët në këtë fazë gradimi, dhe se nga analizimi i testit me shkrim të ankuesit të datës 25.11.2024, rezulton se i njëjti për përgjigjet e ofruara ka arritur gjithsej 71 pikë të përgjithshme, respektivisht 13 pikë nga përgjigjet e përpiluara me shkrim dhe 58 pikë nga përgjigjet e ofruara për pyetjet me një përgjigje të saktë. Rrjedhimisht, duke qenë se ankuesi ka kaluar pragun e arritshmërisë prej 70 pikë, i njëjti ka vazhduar tutje në fazën tjetër të vlerësimit përfundimtar atë të intervistës me gojë, ku nga kjo fazë vlerësimi i njëjti ka arritur gjithsej 62.3 pikë, duke arritur kështu gjithsej 66.65 pikë të përgjithshme, ashtu që pretendimet ankuesit janë të pa bazuara dhe nuk gjejnë mbështetje nga provat materiale të ofruara nga organi i punësimit, por as nga ankuesi i cili përveç thënieve si në ankesë me asnjë dëshmi apo provë tjetër konkrete nuk ka mundur të vërtetoj dyshimet e tij se Komisioni ka qenë i një anshëm apo nuk e ka vlerësuar drejtë arritshmërinë e kalueshmërisë së tij për faktin se i njëjti ka arritur pikët për të kaluar testin me shkrim dhe ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të kësaj procedure gradimi. Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Kriteret e Gradës Udhëheqës, dhe marrë për bazë kriteret themelore të konkursit përkatës, të cilat ishin: *Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; Të këtë zotësi të plotë për të vepruar; të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët; Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrat përkatëse; Të mos jete i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penal me dashje; të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë punë në gradën I – Zyrtar Korrektues apo së paku pesë (5) vite përvojë pune në gradën II – Mbikëqyrës, apo së paku tre (3) vite përvojë pune në gradën III – Mbikëqyrës i Lartë; të ketë përgatitje universitare; dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar me të paktën arrin pritshmëritë; të mos ketë masë të shqiptuar disiplinore aktive; dëshmi nga gjykata që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij.;* rrjedhimisht me qëllim të vlerësimit nëse kandidati A.B ka plotësuar kriteret e konkursit ka shqyrtuar aplikacionin e tij të punësimit, nga i cili rezulton se i njëjti lidhur me plotësimin e kriterit arsimor apo përgatitjes universitare ka bashkangjitur Diplomën me Nr.019/17 të lëshuar më datë 30.06.2017 nga Kolegji i Menaxhmentit Internacional “Globus”, mbi të

cilën dokument dëshmohet se i njëjti më datë 23.06.2017 ka mbaruar studimet në Programin Menaxhment Gjeneral Internacional, dhe ka fituar titullin Bachelor i Arteve të kësaj fushe; Diplomën me Nr.106 të lëshuar më datë 05.07.2022, nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike-Fakulteti i Sigurisë Publike, me të cilin dokument vërtetohet se i njëjti më datë 29.04.2022 mbaroi studimet dhe morri titullin Bachelor i Sigurisë Publike. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës i njëjti ka bashkangjitur Vendimin me numër protokolli 1317 të datës 29.12.2024, të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i SHKK-së, mbi të cilin dëshmohet se i njëjti nga data 01.10.2013, është i punësuar në Burgun e Sigurisë së Lartë në kuadër të SHKK-së; Akt emërimit AE.Nr.088/2022 të datës 15.12.2022, mbi të cilin dokument zyrtar vërtetohet se kandidati në fjalë po nga kjo datë është emëruar Mbikëqyrës i Lartë në Burgun e Sigurisë së Lartë/SHKK; Vendimin me numër protokolli 169 të datës 16.02.2024. mbi të cilin akt dëshmohet se i njëjti nga kjo datë është caktuar Zëvendësues i Udhëheqësit të Njesisë për Pranim dhe Trajtim të Personave të burgosur në Burgun e Sigurisë së Lartë (Pavijoni 3), me gradë IV.. Ndër të tjera, kandidati A.S, ka bashkangjitur Certifikatën mbi dënimet penale, të lëshuar me datë 26.08.2024, nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës përmes të cilës dëshmohet se nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë; Vërtetimin e datës 26.08.2024 të lëshuar nga Policia e Kosovës, sipas së cilit rezulton se i njëjti nuk ka të dhëna të ruajtura në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës; Vërtetimin e datës 09.09.2024 të lëshuar nga Njësia Juridike dhe Punë të Përgjithshme e SHKK-së, mbi të cilin dokument vërtetohet se i njëjti nuk ka masë disiplinore në fuqi; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 16.01.2023, nga i cili rezulton se i njëjti është vlerësuar me notën e përgjithshme prej 3.38; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 16.01.2024, nga i cili rezulton se kandidati në fjalë është vlerësuar me notë të përgjithshme prej 4.05; Po ashtu i njëjti ka bashkangjitur diplomën e shkollës së mesme, dokumentin e identifikimit se dhe një numër të konsiderueshëm të certifikatave të trajnimeve dhe aftësimeve profesionale të përfunduara. Andaj, duke qenë se kandidati A.B plotëson kriteret për gradim në gradën Udhëheqës, dhe se pas përfundimit të procesit të gradimit i njëjti është renditur si kandidati me më së shumti pikë, përkatësisht gjithsejtë 91.5 pikë të përgjithshme, Komisioni i Pranimet me rastin e publikimit të listës me numër protokolli 536 të datës 31.12.2024, mbi rezultatet përfundimtare duke shpallur kandidat A.B, kandidatë fitues për pozitën *Udhëheqës i Pavijonit* në Burgun e Sigurisë së Lartë, ka vepruar në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues.

Theksuar si më sipër, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.224/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit G.SH.;
- Menaxherit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.